



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20587 Prot.

Lezhë, më 03. 12. 2025

VENDIM

Nr. 111, Datë 26. 11. 2025

**PËR SHPALLJEN E DATËS 1 MARS SI “DITA E ARBËRESHËVE” NË
BASHKINË LEZHË DHE MIRATIMIN E PROGRAMIT VJETOR TË
AKTIVITETEVE PËR KËTË DITË**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe aktet nënligjore për mbështetjen e komuniteteve shqiptare jashtë vendit; Referencat historike dhe kulturore që lidhin trevën e Lezhës me trashëgiminë arbëreshe; Nevojën për forcimin e identitetit kulturor dhe për promovimin e bashkëpunimeve me komunitetet arbëreshe; pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Bashkisë si dhe propozimeve e diskutimeve të anëtarëve, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1. Shpalljen e datës 1 Mars si “Dita e Arbëreshëve” në territorin e Bashkisë Lezhë.
2. Kjo ditë përfshihet në kalendarin zyrtar të aktiviteteve vjetore të Bashkisë dhe gëzon status festiv e kulturor në nivel vendor.
3. Qëllimi i kësaj dite është promovimi, ruajtja dhe transmetimi i trashëgimisë kulturore, gjuhësore dhe historike të komunitetit arbëresh.
4. Objektivat kryesorë:
 - 4.1. Nxitja e marrëdhënieve me komunat arbëreshe në Itali;
 - 4.2. Përcjellja e vlerave arbëreshe tek brezat e rinj;
 - 4.3. Prezantimi i kulturës arbëreshe si pasuri e identitetit lokal dhe kombëtar;
 - 4.4. Organizimi i aktiviteteve që mbështesin edukimin kulturor, promovimin e turizmit dhe bashkëpunimet institucionale.
5. Miratohet hartimi dhe zbatimi i një programi të përvitshëm aktiviteteve për datën 1 Mars, i cili përfshin:
 - 5.1. Simpoziume, konferenca dhe diskutime mbi historinë, gjuhën dhe kulturën arbëreshe;
 - 5.2. Panair kulturor me prezantime të traditave, kulinarisë, artizanatit dhe veshjeve

arbëreshe;

- 5.3. Aktivitete edukative dhe shkollore dedikuar kulturës arbëreshe;
 - 5.4. Koncerte, recitale muzikore, ekspozita dhe prezantime artistike;
 - 5.5. Takime dhe shkëmbime me delegacione nga komunat arbëreshe;
 - 5.6. Nismën “Java Arbëreshe”, me aktivitete që paraprijnë datën 1 Mars.
6. Për organizimin e aktiviteteve, ngarkohet Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe njësitë administrative.
 7. Bashkia Lezhë autorizohet të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me komunat arbëreshe dhe institucionet kulturore të komunitetit arbëresh në Itali.
 8. Bashkia mund të aplikojë në programe kombëtare dhe europiane për financimin e projekteve që lidhen me trashëgiminë arbëreshe.
 9. Për realizimin e veprimtarive të “Ditës së Arbëreshëve” parashikohet një fond i dedikuar në buxhetin vjetor të Bashkisë.
 10. Shoqëria civile, bizneset dhe fondacionet mund të kontribuojnë financiarisht apo në natyrë në mbështetje të aktiviteteve.
 11. Bashkia harton një plan komunikimi për promovimin e “Ditës së Arbëreshëve”, duke përdorur mediat sociale, faqen zyrtare dhe kanalet e tjera të informimit publik.
 12. Gjatë javës së aktivitetit, në hapësirat publike vendosen elemente simbolike të kulturës arbëreshe.
 13. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 14. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**





K13

Nr. 20587/1, prot

Dt: 12.12.25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIKNr. 1191/8 Prot.Lezhë, më 11.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut" të ndryshuar ; nenin 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar ,konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.111 ,datë 26.11.2025 të këshillit të bashkisë Lezhë " Për shpalljen e datës 1 Mars si "Dita e Arbëreshëve "në bashkinë Lezhë dhe miratimin e programit vjetor të aktiviteteve për këtë ditë".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

